

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregullt e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve të tjera pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale.

Mbledhja e Komisionit është mbajtur me 03. 08. 2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq, kryetar;
2. Veron Halili, anëtar;
3. Tripo Matijeviq, anëtar;
4. Ivana Krushçiq, anëtare;
5. Frashër Selimaj, anëtar.

Mirheta Gaçevis, anëtare, nuk mori pjesë në mbledhje për shkak të obligimeve të marrura më parë, për ç'gjë me kohë e njoftoi kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lekoviç, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutimi dhe deklarimi lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e katërt e rregullt e Komisionit;
2. Bisedë me redaktorët e programit për pakica, redaksive të programit në gjuhën shqipe dhe programit në gjuhët e bashkësive të tjera në Televizionin e Malit të Zi;
3. Reagim me rastin e shpalljes së pasaktë të emrit të Këshillit rom, në portalin e RTMZ;
4. Të ndryshme.

I

Procesverbali nga mbledhja e katërt e rregullt të Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (5 vota PËR)

II

Për pikën e dytë të rendit të ditës është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesve të RTMZ nga programi për pakica, udhëheqësit Senad Gilaj, redaktorit të programit për bashkësitë nacionale në TVMZ, Bogiq Rakoçeviq, redaktorit të programit në gjuhën shqipe në TVMZ, Nikë Kalaj, redaktorit të programit në gjuhën shqipe në RMZ, Marash Dedvukaj.

Admir Adroviq i pari ju drejtua me pyetje Bogiq Rakoçeviq. Pyetjet kishin të bënin në numrin e të punësuarve në redaksi dhe nëse ka të punësuar nga bashkësia boshnjake, informatë për emisionin “Mostovi”, dhe mundësinë e shtimit të kohës së emitimit si dhe nëse kanë vërejtje në mënyrën punës së redaksisë dhe propozime për avancim. Gjithashtu nëse janë propozuar përmbajtje të reja në Planin programor dhe të produksionit për vitin e ardhshëm.

Bogiq Rakoçeviq u përgjigj se në redaksi janë katër të punësuar, si dhe se njëri prej tyre është i përkatësisë boshnjake. Gjithashtu theksoi se emisioni, “Mostovi” emetohet një herë në javë dhe se është me karakter prozaik. Ajo trajton tema nga jeta, puna, historia, kultura, tradita e popujve pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale. Gjithashtu tha se kohëzgjatja e emisionit varet nga qëndrimi i menaxhmentit të RTMZ. Krahas kësaj, redaksia merret me përgatitjen e temave të caktuara për programin informativ. Ai po ashtu theksoi se për vitin e ardhshëm janë propozuar emisione të reja me karakter të specializuar nga kultura, krahas emisionit, “Mostovi”. Bogiq Rakoçeviq konsideron se trajtimi i programit nuk është i kënaqshëm, duke pasur parasysh se ai do të duhej të jetë themel i servisit publik. Në periudhën e kaluar janë drejtuar mjetet e caktuara për nevojat e redaksive, për ç’gjë është vazhduar kështu, gjë që pamundëson punën kualitative. Ai tha se është shqyrtuar mundësia e fuqizimit kadrovik me një korrespondent nga veriu dhe një nga jugu, por kjo nuk është realizuar sepse nuk është paraparë vendi me aktin e sistematizimit. I vetmi vend që është paraparë është për përfaqësuesit e popullatës rome, por nuk kanë arritur që të sigurojnë ndonjë person me kualifikim të duhur, i cili do të ishte i interesuar për punën në redaksi. Ai tha se edhe më parë ka marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit, por konsideron se mundësitë e tij për të ndikuar në tejkalimin e e problemeve janë të pamjaftueshme, që kështu ka qenë edhe në periudhën e kaluar.

Ivana Krushçiq konsideron se emisionet duhet të jenë më të gjata dhe se emetimi i tyre duhet të jenë në nivel ditor. Gjithashtu konsideron se Komisioni duhet të përpiket për iniciativat e veta ndaj Këshillit të RTMZ, në mënyrë që të përmirësohet pozita e tashme.

Tripo Matijeвиq i njoftoi përfaqësuesit e redaksive se për këtë është bërë fjalë edhe në njërin nga mbledhjet e kaluara dhe se të gjithë anëtarët e Komisionit janë të pajtimit se përqindja e programit është në nivel shumë të ulët.

Bogiq Rakoçeviq theksoi se ai në redaksi ka qenë afër 30 vite, dhe se ka realizuar më shumë se 40 filma dokumentar nga të gjitha trevat e Malit të Zi dhe se do të duhej që në këtë drejtim të mendohet. Gjithashtu theksoi se e gjitha bazohet në iniciativa individuale, gjë që nuk është mirë. Frashër Selimaj konstatoi se në njërin nga mbledhjet e kaluara ka paraqitur pyetjen e korrespondentit nga Plava dhe Gucia, për ç’gjë është dërguar iniciativa edhe drejt Këshillit të RTMZ, dhe se për këtë nuk ka fituar përgjigje.

Senad Gilaj u përgjigj se ka korrespondent nga rajoni i Plavës dhe Gucisë tash disa muaj, mirëpo ai nuk i ka plotësuar pritjet, respektivisht se nuk janë të kënaqur me punën e tij dhe se do ta ndërpresin bashkëpunimin. Krahas kësaj ai tha se janë duke punuar në gjetjen e personit tjetër, mirëpo edhe krahas tentimeve të shumta, ende nuk kanë arrit që të gjejnë ndonjë kuadër kualitativ i cili këtë punë do ta bëjë në formë honorari, derisa të mos vërtetohet aftësia e tij për kryerjen e punës respektivisht detyrave të dhëna. Bashkërisht është konstatuar se do të vazhdojnë me përpjekje që edhe kjo çështje të zgjidhet.

Tripo Matijeвиq ka pyet nëse redaksia ka numër të mjaftueshëm të tonistëve, kameramanëve, shoferave për nevojat e tyre, si dhe çfarëdo përgatitje tjetër teknike.

Ivana Krushçiq ka pyetur se sa është numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe me çfarë konkretisht merren

Senad Gilaj pas raportit hyrës për punët e redaksive të pakicave, tha se janë të punësuar 10 persona, por ekziston problemi i mungesës së tyre, respektivisht pushimeve disa mujore mjekësore dhe se punojnë në kushte shumë të vështira.

Admir Adroviq pyeti nëse në mungesë disamujore të pushimeve mjekësore, RTMZ i punëson njerëzit në kohë të caktuar të cilit do t’i ndërronin ata.

Senad Gilaj u përgjigj se ai për këtë nuk është i njoftuar, duke theksuar se tani kanë bashkëpunim të mirë me menaxhmentin e RTMZ. Gjithashtu theksoi se nga muaji shtator planifikojnë fillimin e punës të radios së posaçme në gjuhën shqipe, por vihet në pyetje se si do të realizohet ai pasi që mungon kuadri.

Tripo Matijeviq theksoi se duke pasur parasysh se shteti i mbulon shpenzimet e pushimeve mjekësore, nuk ka arsye që të mos shpallet konkursi dhe të punësohet dikush që do ta kryente punën në mënyrë të duhur edhe pse e kupton se çështja e pushimeve mjekësore është problem sistematik. Ai theksoi se duhet t'i drejtohen Këshillit me këtë kërkesë si edhe për çështjen e pajisjeve të domosdoshme.

III

Veron Halili i njoftoi anëtarët për lëshimin e Portalit të RTMZ, i cili ka të bëjë me bashkësinë e tij. Me rastin e drejtimit të kryetarit të bashkësisë rome, kryeministrit të Malit të Zi, gabimisht është cekur emri i tij. Kritika më së shumti ka të bëjë me atë se nuk është kërkuar falje për këtë rast. Anëtarët tjerë të Komisionit janë pajtuar me konstatimin e tij dhe konstatuan se për këtë rast do t'i drejtohen Këshillit të RTMZ.

Ivana Krushçiq theksoi se ky nuk është rast i vetëm, se edhe disa ditë më parë në Portal është përdorur termi, “kisha e Serbisë”, gjë që është e papranueshme.

IV

Në kuadër të pikës, të ndryshme, nuk pati tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E MBAJTI
Ivan Lekoviq

KRYETARI I KOMISIONIT
Admir Adrovic